



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

ROLI I STUDENTËVE MUSLIMANË NË RINDËRTIMIN E BOTËS ISLAME

Mevdudi

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

HYRJE.....	5
POZITAT E NGJASHME DHE PROBLEMI I NJËJTË.....	6
UMMETI ISLAM I PËRFSHIN TË GJITHË MUSLIMANËT E BOTËS.....	6
KUPTIMI I JETËS DHE I VDEKJES SË POPUJVE	7
DOMOSDOSHMËRIA E BARTJES SË TRASHËGIMISË KULTURORE NË GJENERATAT E ARDHSHME	8
DY METODAT E BARTJES SË TRASHËGIMISË KULTURORE	9
ROLI I STUDENTËVE.....	9
DETYRA PARËSORE E QEVERISË.....	10
PARIMET THEMELORE TË ISLAMIT	11
DOMOSDOSHMËRIA E RUAJTJES SË KONCEPTEVE THEMELORE.....	12
BESNIKËRIA E PLOTË NDAJ PARIMEVE DHE NDAJ CIVILIZIMIT ISLAM.....	13
DOBËSITË E IDEOLOGJIVE JOISLAME QË E PËRSHKOJNË SHOQËRINË ISLAME	14
INICIATORËT E KULTURËS JOISLAME NË MESIN E STUDENTËVE MUSLIMANË JANË KRIMINELË	16
PËRGJEGJËSIA PERSONALE E MUSLIMANËVE.....	17

RITJA E PUNËVE DHE E KUNDËRVAJTJEVE TË PANDËRSHME DHE SHKAQET QË SJËLLIN DERI TE KJO DUKURI.....	18
UDHËZIMET ISLAME JANË I VETMI SHËRIM.....	19
MËSIMDHËNËSIT MASHTRUES DHE RREZIKU I MADH QË ATA PARAQESIN PËR ISLAMIN.....	21
TË METAT E SISTEMIT ARSIMOR BASHKËKOHOR.....	22
ISLAMI DHE SHKENCA.....	23
DY ANËT THEMELORE TË SHKENCËS.....	24
NJË DETYRË TJETËR E QEVERIVE TONA.....	26
NEVOJA PËR STËRVITJE USHTARAKE ISLAME.....	27

HYRJJE

Para se ta filloj ligjërimin përkatës, më lejoni që ta shpreh lumturinë time me faktin se, falë Mëshirës së All-llahut, nëpër kolegjet dhe nëpër universitetet e shteteve muslimane, gjendet një numër i konsideruar studentësh, zemrat e të cilëve flakërojnë me zjarrin e BESIMIT (IMANTIT); të cilët janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre si muslimanë dhe të cilët bëjnë çmos që, nëpër institucionet e tyre, të gjallërojë fryma Islame. Askush nga ata, të cilët digjen nga entuziazmi për t'u shërbyer vendeve Islame, nuk mund të mos e respektojë këtë fakt. Është bekim nga All-llahu xh.sh., që, përkundër ndikimit të dukshëm të mendimit dhe të civilizimit perëndimor mbi sistemin tonë arsimor, rinia Islame ka bërë që prania e saj të ndihet nëpër institucionet arsimore. Ajo me gjithë vështirësitë e shumta, detyrat e veta është duke i kryer me devocion të zjarrtë.

Tema, rreth së cilës do t'i paraqes pikëpamjet e mia, është: “Çfarë duhet të jetë roli i studentëve muslimanë në rindërtimin e ardhshëm të Botës Islame”.

POZITAT E NGJASHME DHE PROBLEMI I NJËJTË

Në këtë kontekst do të kuptohet qartë se u drejtohem studentëve të të gjitha atyre vendeve Islame të cilat, në saje të varësisë së tyre nga Imperializmi perëndimor, ose në bazë të eksploatimit të tyre, kanë qenë të sunduar nga ana e shteteve perëndimore në çdo fushë të veprimtarisë; nga filozofia dhe nga civilizimi i tyre, ndaj u janë nënshtruar zakoneve e udhëzimeve, teorive dhe programeve që u janë imponuar nga Perëndimi. Sipas mendimit tim, rrethanat që mbizotërojnë në të gjitha këto shtete (vende) ndjekin modelin e njëjtë, kështu që studentët e këtyre shteteve ballafaqohen me probleme të ngjashme.

UMMETI ISLAM I PËRFSHIN TË GJITHË MUSLIMANËT E BOTËS

Pika e dytë, e cila nuk duhet t'i shpëtojë vëmendjes sonë është se Botën Islame nuk e përcakton vetëm shtrirja e saj gjeografike e as emri i maleve, i lumenjve dhe i rrafshnaltave të shteteve të banuara me muslimanë. Ajo i nënkupton popujt, jetën e tyre, civilizimin dhe kulturën e tyre. Këta popuj, në përgjithësi, janë të vdekshëm. Secili nga ata pushon së ekzistuari pas përfundimit të rolit të tyre të caktuar në jetë. Mirëpo, civilizimi i tyre, kultura e tyre dhe mënyra e jetës së tyre, mund të mbijetojnë vetëm me kusht që ata, pasardhësve të vet, t'ua dorëzojnë trashëgiminë e vet në dëlirësinë e saj të panjolllosur, dhe t'i aftësojnë plotësisht gjeneratat e ardhshme, që të njëjtën t'ua bartin gjeneratave që vijnë pas tyre.

KUPTIMI I JETËS DHE I VDEKJES SË POPUJVE

Popujt, të cilët kanë pushuar së ekzistuari, nuk do të thotë se patjetër kanë përjetuar shfarosje. Fakti se janë bërë joekzistues, nënkupton se karakteristikat e tyre kombëtare janë zhdukur. Kur flasim për shkatërrimin e babilonasve ose të egjiptasve të lashtë, të kohës së Faraonit, ne kemi parasysh se bartësit e civilizimit babilonas si dhe ata të civilizimit të Faraonit, kanë humbur civilizimin dhe veçoritë e tyre dalluese. Ende ka njerëz, që i banojnë viset babilonase, mirëpo shenjat e identitetit të tyre të lashtë kanë humbur. Pasardhësit e egjiptasve të lashtë ende i banojnë tokat e Egjiptit, por civilizimi i Faraonit është i vdekur, për shkak se ata nuk patën sukses që pasardhësve të vet t'ua bartin trashëgiminë e tyre kulturore në mënyrë të pagjymtuar. Nëse një gjeneratë përkatëse e një kombi e përvetëson një kulturë të huaj, duke humbur identitetin e vet kombëtar, kjo do të thotë se, nga aspekti kulturor, ai komb është i vdekur. Historia na mëson se, me kalimin e kohës, janë zhdukur më tepër se dhjetë fise të beni israilëve, duke mos lënë kurrfarë gjurme për identitetin e tyre. Kjo nuk do të thotë se ata i janë nënshtruar ndonjë masakre masive ose se janë çrrënjësuar plotësisht. E vërteta është se ata kanë humbur ndjenjën e tyre izraelite dhe se gjeneratat e tyre vijuese kanë pushuar së identifikuari si izraelitë.

Meqë e kishin humbur lidhjen me veçoritë dalluese të civilizimit dhe të kulturës izraelite, ata u tretën plotësisht në kombet tjera, ndërsa identiteti i tyre u zhduk përgjithmonë. Sot, madje as pinjollët (pasardhësit) e tyre nuk e dinë se kanë origjinë izraelite. Që këtu, jeta e një populli varet nga ajo se në ç'mënyrë do t'i përgatisë ai pasardhësit e vet për t'i ruajtur karakteristikat e tyre.

Qëllimi i kësaj ligjërate është që t'ua shpjegoj lexuesve rëndësinë e jashtëzakonshme të çështjeve të zëna nga.

DOMOSDOSHMERIA E BARTJES SË TRASHËGIMISË KULTURORE NË GJENERATAT E ARDHSHME

Tokat, të cilat ne i quajmë Botë Islame, janë çliruar nga stërgjyshërit tanë me qëllim të vendosjes së civilizimit Islam dhe të rendit shoqëror që do t'i kënaqte konceptet tona të jetës, si dhe me qëllim të nxjerrjes së ligjeve të atilla, të cilat nuk veprojnë kundër besimit tonë, por që janë të afërta me parimet Islame. Mbijetesa e Ummetit Islam, si dhe ajo e popujve tjerë, varet nga mënyra se si do t'ua bartim pasardhësve tanë civilizimin, kulturën dhe mënyrën e jetesës Islame, të cilën ne e trashëguam nga paraardhësit tanë.

Kështu, nëse ky transferim i trashëgimisë Islame kryhet siç duhet, atëherë përkundër faktit se individët, në rrjedhën normale të kohës, do të vdesin, mund të sigurohet lulëzimi i vazhdueshëm i Ummetit Islam, në mënyrë që të zgjasë edhe me qindra vite që pasojnë. Në këtë mënyrë nevojitet që t'i jepet rëndësi e duhur aftësive të tyre për ta bartur trashëgiminë e tyre kulturore nga gjenerata në gjeneratë, e në mënyrë që zinxhiri i bartjes së trashëgimisë të vazhdojë së ekzistuari. Nëse ne nuk jemi në gjendje që t'i ruajmë këto veçori dalluese të civilizimit tonë, dhe nëse gjeneratat tona të reja bijnë nën ndikimin e kulturës së huaj, siç është ajo amerikane apo ndonjë kulturë e ngjashme me te, atëherë Ummeti Islam do të zhduket dhe do të zëvendësohet nga popuj të tjerë të infektuar me “amerikanizëm” ose me të ashtuquajturin “westernizëm”. Pasardhësit tanë natyrisht do të jenë aty, por plotësisht të tretur në kallëpin e civilizimit amerikan. Kjo do ta shënonte fundin e kulturës Islame dhe shenjat e kobshme të vdekjes së karakteristikave të Ummetit tonë.

Nga vlerësimi i lartpërmendur, ju mund t'i kuptoni dhe t'i vlerësoni shumë mirë problemet e rinisë si dhe rëndësinë e tyre të jashtëzakonshme. Këto probleme nuk janë vetëm çështje edukative. Ato i përkasin ekzistimit të plotë të identitetit tonë si pjesëtarë të Ummetit si dhe të mbijetesës së tij në të ardhmen. Ne mund të mbijetojmë si Ummet, vetëm me kusht që rinia jonë të arsimohet dhe të ushtrohet në një atmosferë të kulturës Islame. Vetëm atëherë rinia jonë do të jetë në pozitë që ta mbajë lart flamurin e veçorive të veta dalluese.

DY METODAT E BARTJES SË TRASHËGIMISË KULTURORE

Ekzistojnë vetëm dy mënyra për realizimin e qëllimeve të përcaktuara më sipër. E para thërret në iniciativë nga ana e vetë studentëve. E dyta i përket aftësisë së qeverisë në rregullimin e tillë të sistemit arsimor, në mënyrë që sa më lehtë të realizohet qëllimi i përcaktuar. Unë do të merrem me të dy mënyrat veç e veç.

ROLI I STUDENTËVE

Studentët, të cilët studiojnë në kolegje dhe në universitete, në përgjithësi, i takojnë moshës rinore (asaj adoleshente dhe posadoleshente). Ata, deri në një shkallë të caktuar, i kanë zhvilluar aftësitë e tyre për të kuptuar dhe për të gjykuar. Me natyrën e tyre kureshtarë, ata mund t'i drejtojnë

njohuritë e veta kah qëllimet më frytdhënëse, në mënyrë që vetë t'i përcaktojnë shtigjet e veta. Në këtë mënyrë, e tërë përgjegjësia për orientimin e jetës së tyre dhe për përcaktimin e aktiviteteve të tyre, nuk bie vetëm mbi qeverinë. Aktivitetet e studentëve përfshijnë veprime të shumta. Çdo i ri musliman duhet të jetë i vetëdijshëm se është musliman dhe se, në mbarë botën, të rinjtë muslimanë, në vendet e tyre, duhet të jetojnë si muslimanë të vërtetë dhe të drejtë. Ata duhet t'i zotërojnë dhe t'i mbrojnë cilësitë dalluese të ideologjisë dhe të kulturës Islame, humbja e të cilave do ta shënonte edhe humbjen e identitetit të tyre si pjesëtarë të Ummetit.

Tani në rradhë është metoda e dytë:

DETYRA PARËSORE E QEVERISË

Është detyrë e çdo qeverie që t'i gjurmojë shkaqet e korrupsionit në jetën publike. Përkundër ligjeve dhe masave preventive, korrupsioni ka arritur përmasa habitëse dhe e ka hedhur tërë administratën tonë, jashtë binarëve të saj. Ligjet e aprovuar për pengimin e një dukurie të tillë, në saje të pandershmërisë së zbatuesve të këtyre ligjeve, janë bërë të pavlefshme. Çdo restriksion i propozuar nga ligji, shtron udhë të reja për veprime edhe më të mëdha ilegale. Situata e këtillë ia hap dyert tradhëtisë. Sekretet shtetërore, me vlerë të jashtëzakonshme, u dorëzohen shteteve armiqësore me qëllim të fitimit të parave. Kur punët e pandershme dhe shitja e ndërgjegjes fillojnë ta zotërojnë mendjen e njerëzve, atëherë ata janë në gjendje që ta sakrifikojnë popullin e tyre, vendin e tyre, fenë e tyre, besimin dhe tiparet e tyre, vetëm për hir të fitimit personal. Ata

bëhen vegla në duart e elementeve përçarëse të brendshme dhe të jashtme, të cilat gjithmonë me vigjilencë mundohen që sa më shumë ta shfrytëzojnë falimentimin (degradimin) moral të një shteti të huaj.

PARIMET THEMELORE TË ISLAMIT

I tërë koncepti fetar i Islamit, sillet pikërisht rreth këtyre tri shtyllave: Njëjesisë së All-llahut xh.sh. (TEVHIDI), dëshmisë së Pejgamberisë dhe të Ditës së Gjykimit. Duhet t'i bëhet e qartë çdo muslimani, në veçanti, se nëse në mendjen e një muslimani, ekziston edhe elementi më i parëndësishëm i dyshimit, mbi vlerësimin e vërtetësisë së këtyre tri koncepteve themelore, atëherë ai nuk mund të jetë i kualifikuar për ta çmuar dhe për ta udhëhequr jetën e tij brenda kufijve të rendit shoqëror Islam, e as për të marrë pjesë në mirësinë e civilizimit Islam. Çdo risi, që është në kundërshtim me parimet themelore të Islamit ose që zgjon dyshime lidhur me to, e godet civilizimin Islam në rrënjët e tij. Bota Islame nuk mund të mbijetojë, po qe se në të nuk lulëzon kurrfarë ideologjie kulturore Islame. Pa konceptet e tri shtyllave të Islamit - Tevhidit, besimit në Pejgamberinë dhe në Ditën e Gjykimit - do të ishte e pamundur që të qëndrojë civilizimi Islam, struktura e të cilit, në fakt, mbështetet në to.

DOMOSDOSHMERIA E RUAJTJES SË KONCEPTVE THEMELORE

Çështja më e rëndësishme që meriton vëmendjen tonë, është roli, të cilin duhet ta kenë studentët e frymëzuar me ideologjinë Islame dhe nderi në luftimin me mish e me shpirt kundër të gjitha lëvizjeve që nxisin ateizmin ose, ngjashëm me të, që krijojnë mosbesim lidhur me besimin themelor Islam. Ata kurrë nuk guxojnë të lejojnë që të mbijë ndonjë ide, e cila do ta inkurajonte revoltën kundër këtij besimi. Të luftuarit e këtyre tendencave shkatërruese, me të gjitha forcat, është rrugë e vetme për sigurimin e mbijetesës së Islamit, dhe të rritjes së shëndoshë të Ummetit Islam. Çdonjëri që krijon dyshim lidhur me këto tri parime kardinale, jo vetëm që e humb kredibilitetin e vet si musliman, por po ashtu bëhet edhe tradhtar i kauzës së tërë Komunitetit Islam dhe është fajtor për goditjen e ideologjisë Islame në vetë rrënjët e saja. Që këtu, studentët muslimanë duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë lidhur me situatën e lartpërmendur. Po qe se në të kaluarën ka pasur aksione ngurruese nga ana juaj, ato tani duhet të zëvendësohen me aksione të shpejta dhe efikase, për ta prerë rrezikun që në rrënjë. Kurrë nuk duhet lejuar në asnjë shkollë, në asnjë kolegji e në asnjë universitet të përhapen mendimet tepër të lira dhe konceptet ateiste. Në këtë mënyrë, kurrfarë ideologjie e ngjashme, që nxit mosbesim ndaj besimit themelor të Islamit, nuk duhet ta fitojë as rastin më të brishtë për të mugulluar.

BESNIKËRIA E PLOTË NDAJ PARIMEVE DHE NDAJ CIVILIZIMIT ISLAM

Pika e dytë me rëndësi, në të cilën rinia jonë duhet ta përqëndrojë vëmendjen, është fakti se mbijetesa jonë varet njëjloj si nga të besuarit në Islam, ashtu edhe nga zbatimi i moralit Islam. Ekziston një lidhje e fortë midis besimit dhe parimeve morale. Njëri e plotëson tjetrin. Feja jonë, Islami, kërkon respektimin dhe zbatimin e qëndrimeve të përcaktuara morale. Nëpër institucionet tona arsimore, për një kohë mjaft të gjatë, është lënë pas dore zhvillimi i karakterit të shëndoshë moral. Përkundrazi, janë zhvilluar vlera të reja e që kanë ushqyer parime të reja kulturore e morale. Duhet ta kemi plotësisht të qartë se nuk mund të bëjmë kurrfarë progresi duke u bazuar mbi vlerat e reja morale, të cilat i janë përshtatur të ashtuquajturit përparim të shteteve perëndimore. Ne mund ta shpejtojmë marshimin tonë kah progresi, vetëm duke u mbështetur në vlerat morale të përcaktuara nga Islami. Përkundër dëfrimit të tij me anën e të kënduarit, të vallëzuarit, të pirjes së alkoolit, të veprimeve dhe të veseve të tjera amorale, njeriu i Perëndimit akoma është në gjendje që të bëjë sakrifica për hir të vendit të vet; për shkak se ai është ushqyer me një filozofi materialiste, e cila nuk i kundërshton dëfrimet e tjera më të lakmueshme. Mirëpo, nëse muslimani llastohet me dëfrimet e zëna ngoje, duke e ditur shumë mirë se aktet e tilla i janë ndaluar nga All-llahu xh.sh., dhe nga ana e Pejgamberit a.s.; atëherë ai do të dënohet për shkak se është ngritur kundër parimeve themelore Islame. Njeriu i Perëndimit duke u “kënaqur” me këto dëfrime të preferueshme, nuk e cenon kodin e standardeve të tjera morale; mirëpo kur ne i pranojmë këto veprime, atëherë jemi fajtorë për fyerjen e atyre parimeve të shenjta, të cilat janë mbështetje e moralit tonë. Që këtu, i dehuri musliman ndryshon shumë nga ai me identitet

jomusliman. Është e vërtetë se vera është njësoj e dëmshme edhe për muslimanin edhe për jomuslimanin, por ekziston njëfarë dallimi midis këtyre dyve. Jomuslimani, përkundër faktit se vera nuk i ndalohet nga religjioni i tij, me vet aktin e pirjes, e konsumon një substancë të dëmshme. Kështu, ai nuk është fajtor për fyerjen e besimit të vet. Mirëpo, muslimani nuk e kryen këtë krim, vetëm nëse nuk e ushqen ndjenjën e revoltës kundër All-llahut xh.sh., dhe Pejgamberit të Tij, Muhammedit a.s.; si dhe ndjenjën e dyshimit lidhur me Ditën e Gjykimit. Çështja nuk përfundon vetëm me shkeljen e këtij ligji. Ai vazhdon së cenuari të gjitha ligjet, të cilat i përkasin abstenimit, dhe vazhdon së shkeluri të gjitha kodet morale, deri në atë shkallë kur ndjenjat e tij bëhen të vdekura për çfarëdo gjëje të shenjtë.

DOBËSITË E IDEOLOGJIVE JOISLAME QË E PËRSHKOJNË SHOQËRINË ISLAME

Mund të vërehet mjaft qartë se, nëse një ideologji joislame përshkon shoqërinë muslimane, atëherë pasojat e saja të dëmshme janë shumë më të rrezikshme se që janë të njëjtat për një shoqëri jomuslimane. Në shoqërinë jomuslimane, ato mund ta kenë efektin e njëjtë si ndonjë veprim i ndonjë individi apo i ndonjë kombi, e që është si rezultat i pirjes së verës ose i kryerjes së akteve të tjera të gabueshme. Mirëpo, nëse ne muslimanët i pranojmë sjelljet e tilla mëkatore, atëherë feja jonë e çiltër do të njolloset, ndërsa rrënjët e besimit tonë do të dobësohen. Kështu, në vend që në mënyrë të padyshimtë t'i bindemi All-llahut xh.sh., dhe Pejgamberit të Tij, ne

bëhemi të ndjeshëm ndaj një dëshirë të madhe për revoltë kundër Tyre. Dhe kur një herë e pranojmë këtë sjellje të padëshirueshme, për ne tani më bëhet e pamundur që t'i përmbahemi me vendosmëri çfarëdo sistemi të virtyteve morale; thjesht për shkak se, në vend që të shfaqim bindje dhe lojalitet, për çka jemi të detyruar, ne tani më jemi revoltuar kundër All-llahut xh.sh., dhe Pejgamberit a.s., të Tij. Kjo e shpjegon edhe dukurinë se përse një musliman, kur një herë nis ta udhëheqë jetën e vet në kundërshtim me rregullat e Islamit, nuk ndalet në asnjë fazë, por vazhdon me shkeljen e Parimeve Islame njëhën pas tjetrës, gjë që rezulton me harresën e tij të plotë për përgjegjësitë e veta si musliman. Ai nuk është i përgatitur që të respektojë kurrfarë ligji, ndërsa degradimi i tij moral, i kapërcen të gjithë kufijtë. Ai bëhet i paaftë për t'iu përmbajtur çfarëdo ligji të fuqizuar nga cilado legjislaturë, me qëllim të mbrojtjes së ligjit dhe të rendit shoqëror. Kurrë nuk mund të pritët që ai t'i sakrifikojë interesat e tij vetjake, për hir të popullit të tij ose për hir të shtetit, mbase, duke u bazuar në sjelljet e tija, asnjëri nga këto të dy nuk meriton përkushtim po qe se krahasohen me adhurimin e All-llahut xh.sh., autoritetin e të cilit ai tani më është mësuar ta kundërshtojë dhe ta përqeshë. Urrejtja e tij për mosrespektimin e ligjit, është ngulitur në natyrën e tij, ndërsa përqeshja e atyre që e përcaktojnë ligjin, është bërë stili i tij jetësor. Individit i tillë, nuk është i aftësuar që të jetë anëtar i çfarëdo shoqërie civilizuese, e mos të flasim për ruajtjen e lidhjeve të tija me shoqërinë Islame.

INICIATORËT E KULTURËS JOISLAME NË MESIN E STUDENTËVE MUSLIMANË JANË KRIMINELË

Çdonjëri, i cili e kupton këtë fakt të qartë, do ta ndjejë se ata, të cilët në mesin e studentëve muslimanë ngjallin tendenca të atilla siç është çmenduria për muzikë dhe për këngë, dhe i bën ata të kënaqur në shfrenimin e tillë; janë fajtorë për futjen e sjelljes joislame në mesin e tyre dhe për injektimin qëndrimeve për thyerjen e ligjeve morale të Islamit. Ata në këtë mënyrë kryejnë një krim të rëndë dhe janë vepruesit më të ligj të vendit të tyre. Rinia jonë studentore duhet t'i kuptojë të gjitha pasojat e dëmshme të tendencave të tilla. Edhe po qe se një njeri, i ngarkuar me përgjegjësinë e udhëheqjes së administrimit të një shteti dhe në saje të mungesës së mprehtësisë së mirëfilltë mendore të tij, fut zakone të tilla amorale dhe bën aso ligësi; është detyrë e studentëve që ta ruajnë veten larg nga këto zakone dhe t'u rezistojnë të gjitha ngasjeve, duke pushuar së kënaquri me to. Nëse ata, nëpër institucionet e veta dhe në shoqëri, krijojnë një opinion të mirë te populli kundër pranimin të zakoneve të tilla të neveritshme, siç është vallëzimi e disa gjëra të ngjashme, atëherë nuk do të kishte fuqi që me dhunë të mund t'i fuste tendencat e liga në mesin e tyre. Vetëm bindja djallëzore është ajo e cila punon në tërheqjen e studentëve kah këto "kultura" dekadente, duke i prishur ata.

Diskutimi i mësipërm paraqet dy mënyrat kryesore të veprimit, me të cilat ata mund t'i zgjedhin këto probleme dhe t'i largojnë këto ligësi që janë futur në institucionet tona arsimore. Për më tepër, studentët duhet ta përqëndrojnë vëmendjen e tyre në të metat e rregullores lidhur me arsimimin fetar, dhe me anë të përpjekjeve të veta, ta kompensojnë mungesën në lëmin përkatës.

Unë, shkurtimisht, do ta paraqes rolin e qeverisë në këtë sferë të veçantë të aktivitetit edukativo-arsimor.

PËRGJEGJËSIA PERSONALE E MUSLIMANËVE

Në qoftë se qeveria nuk kujdeset për këtë çështje, prapëseprapë nuk pushon përgjegjësia personale e studentëve që, si individë muslimanë, ta kuptojnë Islamin dhe të pajisen me njohuri dhe me të dhëna teologjike Islame. Çdo musliman i vetëdijshëm, e ka për detyrë që medoemos të fitojë njohuri lidhur me Islamin, në të cilin ai beson dhe i cili e përcakton atë si musliman. Për njohuri pikënisëse për Islamin, nuk është e nevojshme ndonjë dituri e thellë mbi filozofinë fetare. Me pak përpjekje, përmes leximit të literaturës fetare në gjuhën e vet, një person mund të përfitojë njohuri themelore mbi Islamin. Ai së paku mund ta mësojë dallimin midis muslimanit dhe jomuslimanit. Cilët janë ata faktorë kryesorë, të cilët e dallojnë muslimanin nga jomuslimani? Cilat janë shtyllat themelore të besimit për një musliman, dhe cilat janë detyrat e tij? Cilat janë ato gjëra prej të cilave ai duhet të ruhet? Cilat janë parimet udhëheqëse morale, që duhet të ndiqen, të pranohen dhe të respektohen nga ai?

Për çështjet e këtilla të vogla informative, nuk ka nevojë që të mësohet nëpër institucionet fetare, ose të bëhet studimi i koklavitur shumëvjeçar i filozofisë religjioze. Me pak vëmendje dhe me një çikë përpjekje, çdo musliman i ri mund t'i mësojë dhe t'i zotërojë rudimentet e njohurive fetare, të cilat janë në dispozicion pothuajse në të gjitha gjuhët. Dëshiroj që rinia ta ndjejë se nevoja për

përfitimim e njohurive fetare, në një masë të këtillë, është esenciale, për të qenit musliman të një studenti, e jo për dhënien e provimeve dhe për fitimin e titujve shkencorë.

RITJA E PUNËVE DHE E KUNDËRVAJTJEVE TË PANDERSHME DHE SHKAQET QË SJELLIN DERI TE KJO DUKURI

Korrupsioni i çfarëdo lloji qoftë, si: punët e pandershme, ryshfeti dhe shpronësimi i pavend: është i përhapur anembanë vendeve tona muslimane, kurse shtresa e arsimuar gjendet në ballë të këtyre veprimeve, duke u dëfryer në këto sjellje të papëlqyeshme. Ç’është e vërteta, ata e udhëheqin tërë makinerinë administrative dhe ekonomike. Analfabetët, të cilët i takojnë rrethit rural, nuk kanë asgjë të përbashkët me këtë dukuri. Mirëpo, duhet ta dimë se kjo shtresë e arsimuar është produkt i institucioneve tona arsimore. Kjo, pa mëdyshje, vërteton se në sistemin tonë arsimor, ka disa gabime, të cilat kanë qenë mjet për prodhimin e një numri tejet të madh të individëve me mungesë morali dhe nderi, e të cilët janë dëfryer në kundërvajtjet e ndryshme pa asnjë pikë ndërgjegjeje. Me shqyrtimin e kujdesshëm të gjendjes së përgjithshme, do të na bëhet e qartë se sistemi ynë arsimor, i cili në përgjithësi është perëndimor; si pasojë të natyrshme, në esencë ka disa të meta tejet serioze. Mungesa kryesore është se ky lloj i arsimimit e dobëson bindjen tonë dhe i shkakton goditje parimeve themelore të besimit tonë; e të cilat në të vërtetë janë shtyllat mbi të cilat qëndron e tërë godina e civilizimit dhe e kulturës sonë. Ajo, në arsyen tonë inkuadron një element të dyshimit dhe ca persona i mban në gjendje mohimi. Kështu, pas përfundimit të këtij lloji të

arsimimit, vetëm disa individë dalin të sigurt, pa i humbur rrënjët e besimit të vet. Tani kemi arritur në një gjendje të tillë, ku te pjesa dërmuese e njerëzve të arsimuar, është luhatur besimi në All-llahun xh.sh., në Pejgamberinë dhe në Ditën e Gjykimit. Ne nuk kemi asgjë tjetër që do t'u mundësonte atyre që t'u përmbahen parimeve themelore Islame.

A mundet një njeri, i cili nuk ka frikë nga All-llahu xh.sh., dhe vetëdije për përgjegjësinë në Ditën e Gjykimit, të përmbahet nga zhytja në amoralitet dhe nga sjelljet e papërgjegjësi? A mundet një njeri, i cili përveç ndaj vetes, nuk tregon kurrfarë besnikërie tjetër, ta bëjë sakrificën e të mirave materiale?

Vetëm besnikëria ndaj idealeve të larta e nxit njeriun për sakrifica, ndërsa për një musliman nuk ka besnikëri më të çiltër se që është ajo ndaj All-llahut xh.sh., ndaj Pejgamberit a.s., të shquar, dhe ndaj Ummetit Islam. Nëse kjo besnikëri lëkundet, atëherë pasojat e natyrshme të kësaj do të jenë shfaqjet e parapëlqimeve egoiste dhe të këqia, në të gjitha format e neveritshme; ndërsa vetëm për hir të interesave dhe të parapëlqimeve vetjake, nuk do të ketë kurrfarë ngurrimi në kundërshtimin e çfarëdo ideali.

UDHËZIMET ISLAME JANË I VETMI SHËRIM

Vetëm përmes forcimit të kësaj ndjenjeje për lojalitet, ju mund t'i jepni fuqi besnikërisë së ndonjë personi ndaj së vërtetës, ndaj drejtësisë dhe ndaj nderit. Kur nuk ka ndonjë ndalesë tjetër, vetëm frika nga All-llahu xh.sh., dhe vetëdija për Ditën e Gjykimit, mund ta ndalojnë njerinë që mos të

marrë fitime të padrejta, pa ia nënshtruar veten humbjeve materiale. Me fuqinë morale, që shprehet në besnikërinë ndaj All-llahut xh.sh., dhe në devotshmërinë ndaj Fesë; njerëzit mund të jenë në gjendje që të kryejnë sakrifica të mëdha, të cilat nga jashtë mund të duken se janë katastrofale për të mirat e tyre materiale.

Niveli i vlerave dhe i besnikërive të ithtarëve të besimeve tjera është krejtësisht tjetër. Godina e standardeve të tyre morale, qëndron mbi shtylla tjera. Tani, po qe se dëshirojmë që pikërisht këto standarde dhe këto besnikëri t'i fusim ndër popull, do të duhej të kalonin 50 vjet në vënien e tyre në besimet joislame; ndërsa edhe 50 vjet të tjera do të kalonin, që ato besnikëri të bëheshin gjithëpërfshirëse dhe të shpallura si evropiane. Përkundrazi, ju qysh sot mund të filloni me planin e zhvillimit të karakterit të tyre mbi ideologjinë Islame dhe, brenda disa vitesh, do të shohim rezultate inkurajuese, nga i vetmi shkak se, deri më tani, rinia Islame është pajisur me parimet themelore, dhe se dëshmia mbi qenësinë e Zotit, të Pejgamberisë dhe të Ditës së Gjykimit, u janë sqaruar atyre nga ana e prindërve të tyre. Gjithashtu, ata janë rritur dhe janë edukuar në një shoqëri Islame dhe në një atmosferë të traditës Islame. Me fjalë të tjera, rrënjët tani më gjenden nën tokë. E vetmja gjë që nevojitet është që të bëhet ujitja e këtyre rrënjëve që ato të gjelbërojnë dhe të rriten në drunj, të cilët më vonë do të lulëzojnë dhe do të japin fryte.

Imperialistët britanikë nuk shihnin kurrfarë interesi në civilizimin tonë dhe në virtytet tona morale. Përkundrazi, ata identitetin tonë prej muslimani, e konsideronin të dëmshëm për interesat e tyre. Prandaj, ata themeluan një sistem të arsimit me qëllim që ta dobësonte besimin tonë dhe që do të shtinte një element dyshimi në nyjet fundamentale të besimit tonë; si edhe që do të shërbente si mjet për devijimin tonë nga Islami deri në shkallën më të lartë të mundshme. E nëse ne, edhe pas flakjes së zgjedhës së dominimit të huaj, vazhdojmë së pranuari llojin e njëjtë të

sistemit arsimor, kjo do të thoshte se ne me vetëdije dhe me dëshirë kemi hipur mbi kursin e veprimit i cili, për ne nuk është asgjë tjetër pos vetëvrasës.

MËSIMDHËNËSIT MASHTRUES DHE RREZIKU I MADH QË ATA PARAQESIN PËR ISLAMIN

Një numër i konsiderueshëm i mësimitdhënësve përpiqen që, nëpër institucionet arsimore, të fusin dyshim në mendjen e studentëve. Ata bëjnë përpjekje të vazhdueshme që në zemrat e tyre të lënë përshtypje se Islami nuk ka civilizim të vetin, se nuk ekziston diç që do të mund të emërtohej si kulturë Islame, se Islami nuk ka sistem të vetin politik, se parimet ekonomike të Islamit janë të vjetëruara dhe nuk përputhen me sistemin kompleks bashkëkohor ekonomik, se legjislatura Islame është arkaike (e vjetër) dhe nuk është në kontekst të kushteve bashkëkohore. Po ashtu, ata thonë se kontributi i muslimanëve në analet e historisë njerëzore, nuk zë ndonjë vend të caktuar dhe se të gjithë heronjtë, që i stolisin faqet e historisë, janë jomuslimanë. Unë, me tërë theksin e zotërimit tim, them se mësimitdhënësit, të cilët në këtë mënyrë e keqduhëzojnë rininë tonë dhe mendjen e tyre e helmojnë me ide të tilla perverze, janë tradhëtarët më të mëdhenj të shoqërisë muslimane. Ata godasin në vetë bazamentin e politikës Islame. Asgjë nuk mund të jetë më fatkeqe për Ummetin Islam, nga fakti se gjeneratat e tij të ardhshme dhe rinia e tij, u janë besuar përkujdesjes së llojit të tillë të mësimitdhënësve. Paramendoni se si konfuzioni arrin në urrejtje, kur nëpër universitetet e disa vendeve (shteteve) Islame, Departamenti i Arsimit dhe i Sociologjisë,

udhëhiqet nga amerikanë ose nga mësimdhënës të amerikanizuar, të cilët shërbejnë nëpër poste të larta, e me qëllim që ta helmojnë mendjen e rinisë sonë kundër konceptit tonë të arsimit dhe kundër rendit tonë shoqëror. Vallë, a thua nuk shpie ky sistem kah vdekja jonë si Ummet Islam?

TË METAT E SISTEMIT ARSIMOR BASHKËKOHOR

Është detyrë e qeverive të shteteve muslimane që t'i largojnë këto të liga, të cilat e përshkojnë sistemin e arsimit. Ato po ashtu duhet të shikojnë se mos diçka nuk është në rregull me lëndët e studimit të parapara me program. Problemi i vërtetë është se drejtimit e mësimi janë formuluar nga ana e personëve, të cilët nuk besojnë në ekzistimin e Zotit. Mësimet janë përgatitur në mënyrë që të propagandohet ideja e universit - pa Zot. Ata e njoftojnë popullin se i tërë organizimi i gjithësisë, në të vërtetë, është rezultat i fenomeneve natyrore dhe udhëhiqet nga ligjet natyrore. As Zoti nuk e ka krijuar atë, e as ndonjë Fuqi Mbinatyrore nuk vepron pas saj. Gjithashtu, edhe një koncepton, i cili e formon themelin e këtyre mësimëve si dhe shtjellimin e tyre; është se njeriu është udhëheqës i vetvetes, ai as që ndjen nevojën për ndonjë udhëheqje Hyjnore, e as që pranon ndonjë udhëheqje të tillë. Që të dy këto konceptione, godasin në vetë rrënjët e kulturës sonë. Duhet të bëjmë përpjekje të vendosur që të bëjmë ndërrim në këtë plan dhe që, në përputhje me fenë tonë, të formulojmë sistemin tonë të arsimit. Pa mëdyshje, do të duhet që t'i studiojmë artet, shkencat dhe filozofinë, duke u futur thellë në lëmenjt e tyre, dhe njëkohësisht duhet të përfitojmë nga të gjitha rezervat e diturisë të arritura nga ana e njeriut deri më tani. Mirëpo, po qe se dëshirojmë që ta mbajmë veten në jetë, si muslimanë, do të duhej që,

gjatë studimit të tyre, t'i Islamizojmë të gjitha ato njohuri (dituri). Në të kundërtën, me apo pa dashjen tonë, sistemi i tanishëm arsimor, është në rrugë që ta shkatërrojë identitetin tonë musliman. Sot jemi të ballafaquar me problemin e arsimit tonë; sa më herët që ta kemi një koncept të qartë lidhur me te, aq më mirë për ne.

ISLAMI DHE SHKENCA

Disa njerëz janë të hutuar me marrëdhënien midis shkencës dhe Islamit. Ne e shohim se Bashkimi Sovjetik beson në shkencën sovjetike. “Më thuaj po që se Islami nuk do të duhej të ketë kurrfarë marrëdhënie me shkencën?”.

Në një sistem komunist, askush nuk do të dakordohej që popullit të vet t'i jepet arsimim nga shkencat borgjeze, nga filozofia borgjeze, nga historia, ekonomia, politika, etj. Ai më shumë do të dëshironte që ato tema t'ua mësojë atyre me një nuancë të komunizmit, në mënyrë që shkencëtarët dhe ekspertët komunistë, në arte, të mund të nxirren në skenë (të prodhohen). Asnjë rend komunist nuk mund të mbijetojë, duke i studiuar mësimet borgjeze të formuluar mbi mentalitetin borgjez. E vërteta është se, njerëzit, të cilët kanë civilizimin e vet dhe filozofinë e vet të jetës, nuk do ta tolerojnë një sistem mësimesh antagonist me botëkuptimet e tyre, thjesht për shkak se një sistem i tillë i kërcënohet ekzistencës së tyre, dhe se do të mbaronte me asimilimin e tyre nga ana e një kulture të huaj.

DY ANËT THEMELORE TË SHKENCËS

Thënia se shkenca është universale dhe se, që këtu, nuk duhet të jetë e ndërlidhur me asnjë religjion, shpreh një mungesë të të kuptuarit. Shkenca përbëhet nga fakte dhe nga ligje natyrore të cilat, në njohjen e njeriut, arrijnë përmes eksperimenteve dhe vrojtimeve. Këto, pa dyshim, kanë një rëndësi universale. Nga ana tjetër qëndron truri, i cili analizon faktet, i rregullon informatat, i formulon teoritë dhe, të gjitha këto, i shpreh përmes gjuhës. Kjo gjuhë nuk është as e vetme, e as universale. Ajo determinohet nga pikëpamjet dhe nga qëndrimet e njerëzve të veçantë. Natyrisht, njerëzit me orientime të ndryshme kulturore, të vërtetën shkencore do ta shprehin në mënyra të ndryshme. Qëllimi ynë duhet të jetë shkaktimi i ndryshimit në këtë të dytën e jo në të parën.

Është e vërtetë shkencore se të gjitha substancat, gjatë ftohjes, tkurren, mirëpo kur ftohet uji, e më vonë ngrin, ai pas kalimit të tij në akull, bimehet dhe bëhet i lehtë në peshë. Ky është shkaku që ai pezullon në sipërfaqen e ujit. Ky është fakt, dhe ndonjë person këtë e quan natyrë dhe ndikim të temperaturës mbi ujin. Ndonjë person tjetër, të njëjtën dukuri, ia atribuon Urtësisë së Zotit dhe përkujdesjes së Tij mbrojtëse, në veshjen e ujit me këtë veti të ndihmës për ruajtjen e jetës. Po të mos vepronte kështu, uji i transformuar në trajtë akulli, në vend që të akumulohet në sipërfaqe, do të akumulohet në fundin e të gjithë lumenjve, liqeneve dhe të deteve, dhe si pasojë e kësaj, kurrfarë lloji jetese nuk do të mbetej në to. Mund të vërehet se një fakt i thjeshtë mund të përshkruhet në dy mënyra të ndryshme, bazuar në pikëpamjet e dy personave.

Kështu, duke i lexuar deklaratat e që të dyve, në mendjen e lexuesit krijohen dy përshtypje të veçanta. Lexuesi, duke e lexuar njërin nga deklaratat, impresionohet nga Njëjësia e Zotit, nga Urtësia e Tij, si dhe nga përkujdesja mbrojtëse e Tij. Mirëpo, interpretimin tjetër, ai mund thjesht

ta pranojë si një dukuri shkencore. Një interpretim i tillë, i cili as që i referohet qenësisë së Zotit, përcakton se çdo fenomen në univers ngjan vetvetiu dhe se Urtësia e Krijuesit, ose përkujdesja ushqyese e këtij Mbrojtësi Suprem; nuk ka të bëjë asgjë me të. Përmes këtij shembulli, ju mund të kuptoni se, po qe se shkenca mësohet në mënyrë të sekularizuar, atëherë do të paraqiten shkencëtarë me ideologji materialiste. Mirëpo, po qe se shkenca interpretohet përmes metodës tjetër, atëherë do të përgatiten shkencëtarë që u qëndrojnë besnikë pikëpamjeve Islame.

Në të vërtetë, nuk ekziston ndonjë lëmi e shkencës e që, me qëndrueshmëri, nuk e përforcon BESIMIN (IMANIN) tonë. Çfarëdo lëmie që e studiojmë, si: fizikën, kiminë, biologjinë, fiziologjinë, anatominë, astronominë, etj., ne hasim në aso të vërteta, që janë të mjaftueshme për ta vërtetuar besimin tonë në Islam. Nuk ka nxitje më të madhe, për gjallërimin e Besimit tonë, se që janë të vërtetat e shpallura nga shkenca. Këta janë pikërisht ata tregues, drejt të cilëve, Kur'ani vazhdimisht e tërheq vëmendjen tonë. Mirëpo, për shkak se një mosbesimtar, si shkencëtar, e ka kthyer njohurinë shkencore në një trajtë sistemetike dhe koherente; një person, i cili studion në një sistem të tillë, do të shndërrohet në materialist, ose në ateist, dhe do ta përqeshë konceptin e Zotit.

Do të dëshiroja që qeveritë e shteteve (vendeve) Islame të bëjnë një dallim midis këtyre dy drejtimitëve dhe t'i kuptojnë ato seriozisht, në mënyrë që ta arrijnë rrënjën e problemit. Ne nuk mund të nxjerrim në shesh muslimanë, duke u ofruar atyre mundësi për studimin e shkencave, të filozofisë dhe të mësimëve të tjera, në bazë sekulare. Nëse jemi të vendosur që të mbijetojmë si Ummet, atëherë ne duhet të themelojmë një institucion që do të ishte mjet për kryerjen e riorientimit të plotë të sistemit mësimor dhe të rivendosjes së makinerisë arsimore. Duhet të jetë përgjegjësi e atij institucioni që të përgatisë aso tekste mësimore të shkencave dhe të arteve, që do

të përhapnin diturinë nga këndvështrimi Islam. Po qe se kjo nuk bëhet, atëherë vetë ekzistenca e komunitetit tonë musliman bëhet e dyshimtë, e mos të flasim për mbijetesën e Besimit tonë.

NJË DETYRË TJETËR E QEVERIVE TONA

Një tjetër pikë, që dëshiroj t'ua propozoj qeverive për shqyrtim, është problemi i përgatitjes dhe i edukimit moral. Stërvitja morale është një domosdoshmëri për të gjitha institucionet arsimore. Mirëpo, në rend të parë, është më se e nevojshme nëpër institucionet, të cilat përgatisin kuadro për shërbime qeveritare. Edukata dhe përgatitja Islame duhet të bëhet e detyrueshme në të gjitha qendrat stërvitëse ushtarake, policore dhe administrative. Besimi Islam duhet të ngulitet në to, ndërsa duhet të inkurajohet edhe mbikqyrja e parimeve Islame. Nuk duhet lejuar kurrfarë lëshimi që paturpësitë dhe aktet mëkatore të futen tinzisht. Kjo me siguri do t'i forconte shtetet Islame.

Ne, për shembull, fillojmë të stërvisim një polic dhe, nga vetë fakti se ai quhet Abdullah ose Abdurrahman, nënkuptojmë se ai duhet të jetë musliman. Kështu, ne duhet ta përgatisim atë vetëm për obligimet e tija si polic. Ne interesohemi vetëm për programin e domosdoshëm të stërvitjes, i cili bazohet në disa normativa të pranuar. Mirëpo, nuk bëjmë kurrfarë orvatjeje që ai të stërvitet edhe si musliman. Rrjedhim i kësaj është se ai është i përgatitur mirë që t'i kryejë obligimet e tij të policit, mirëpo, parimet Islame nuk bëjnë pjesë në karakterin e tij. Në një situatë të tillë, po qe se korrupsioni shënon rritje në rradhët policore, nëse krimet marrin hov nën mbrojtjen e tyre dhe nëse kontrabanda nxitet nën mbikqyrjen e tyre, atëherë ne nuk duhet të

ankohemi, pasi që nuk është bërë kurrfarë përpjekjeje që personeli policor njëkohësisht të përgatitet edhe me karakter Islam. Në esencë nuk ka kurrfarë dallimi mes sistemit stërvitës të shteteve tona dhe atij të shteteve jomuslimane. Kur polici i stërvitur në këtë mënyrë përurohet në poste më të larta, ai nuk e dëshmon veten si një oficer i mirë.

NEVOJA PËR STËRVITJE USHTARAKE ISLAME

Ky është fakti që disa ushtri të vendeve Islame kanë dëshmuar akte të trimërisë së spikatur, duke demonstruar një frymë të paepur të përpjekjes për hir të Zotit - Xhihad, një dashuri për dhënien e jetës si Shehid, dhe një entuziazëm të pathyeshëm për flijim. Mirëpo, burimi i të gjitha këtyre përsosmërive, nuk mund të gjendet askund në programet e tyre stërvitëse ushtarake. Gurrat e vërteta frymëzuese, janë nënat muslimane dhe traditat e qëndrueshme Islame, të cilat e kanë ruajtur në ta frymën Islame dhe dashurinë ndaj All-llahut xh.sh., ndaj Pejgamberit a.s., Ditës së Gjykimit, ndaj përpjekjes - Xhihadit - dhe ndaj Martirisë. Mirëpo, në qoftë se ne vazhdojmë t'i gjymtojmë këto mbetje të konceptcionit të Islamit, a thua për sa kohë do të mbijetojnë ato? Gjeneratat e ardhshme do t'i pranojnë të njëjtat në sasi gjithnjë e më të vogla. Nuk mund të pritet që femrat, të cilat janë zhytur në kallëpin e ri të institucioneve tona arsimore, t'ua japin frymën Islame të vegjëlvë të tyre. Fryma e tillë është gjetur vetëm midis atyre femrave, të cilat i kanë parë nënat e veta duke u lutur në shtëpi, dhe prej të cilave kanë mësuar emrat e Zotit dhe të Pejgamberit a.s., dhe i kanë dëgjuar ato duke recituar Kur'anin. Përkundrazi, nënat e reja, gjatë zhvillimit të tyre, diskutojnë rreth aktorëve filmikë, dëfrehen me vlerësimin e filmave të rinj dhe bëjnë biseda të paturpshme mbi

dëfrimet dhe çamarokllëqet. Ato as që e vrasin mendjen për ta shqiptuar emrin e All-llahut xh.sh., dhe të Dërguarit të Tij, Muhammedit a.s. Të rinjtë, pas pjekurisë së tyre në prehërin e nënave të tilla, kurrë nuk mund të pritet që t'i flijojnë jetat e tyre në emër të Zotit dhe të Dërguarit, ose të frymëzohen me atë entuziazëm për martiri, të demonstruar me aq shtjellim nga ana e ushtrive Islame.

Në qoftë se ne me të vërtetë dëshirojmë që të kultivojmë një rini të tillë, e cila për hir të vendit të vet do të ishte e përgatitur që ta flijojë jetën e vet dhe po ashtu edhe për mbijetesën e mënyrës Islame të jetës, ne do të duhej të zotohemi që, së bashku me stërvitjet e ndërlikuara ushtarake, t'u japim atyre udhëzime Islame të virtyteve të larta. Udhëzimet fetare duhet të jenë të atilla, që do ta ushqejnë Besimin e tyre Islam, që do ta zhvillojnë moralin e tyre të dëlirë dhe që do t'ua forcojnë bindjen; në mënyrë që t'u mundësojnë atyre që të flijojnë gjithnjë e më shumë sakrifica.

Vetëm një edukim dhe një arsimim i tillë, mund të na mbajë përballë armikut shumë më të fortë se ne.